



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1298 prot.

Pukë, më 29.06 2022

PROJEKT - VENDIM

Nr. 04 Datë 29.06 . 2022

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË PUKË

Këshilli i Bashkisë Pukë në zbatim të Nenit 54, pika "m" të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; neni 3, pika 1; neni 14, pika 1; neni 15, pika 1/a dhe 2; neni 16, pika 1; neni 17; neni 18; neni 19; neni 20, pika "ç", Vendimit nr. 516 datë 01.07.2020 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.247 datë 20.03.2015 të këshillit të ministrave " Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale e kundër korrupsionit për periudhen 2015-2020 dhe miratimin e planit të veprimit 2020-2023 , në zbatim të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2015-2023 e të pasaportës së indikatorëve, me Propozim të Kryetarit të Bashkisë ,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë bashkëngjitur këtij Projekt-Vendimi, i cili synon uniformizimin e të gjitha Bashkive në rang Kombëtar në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit në komunitet , rritjen e besueshmërisë , transparencës dhe llogaridhënies si dhe përfshirjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e bashkisë. E thënë ndryshe ky plan (dokument) do të sigurojë funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në nivel bashkie si dhe do të ndihmojë administratën vendore në përpjekjet e saj për forcimin e etikës dhe integritetit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Drejtor DMBNJ
Emirjona Pergjegjaj

Jurist
Endrit Kraja

KRYETARI
Gjon GJONAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1298 prot.

Pukë, më 29.08 2022

Relacion

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË PUKE

Mbështetur në ligjin nr. **139/2015**, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Vendimin nr. 516 datë 01.07.2020 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.247 datë 20.03.2015 të këshillit të ministrave “ Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale e kundër korrupsionit për periudhen 2015-2020 dhe miratimin e planit të veprimit 2020-2023 , në zbatim të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2015-2023 e të pasaportës së indikatorëve , me propozim të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

Të miratohet Plani i Integritetit për Bashkinë Pukë i cili ka si **synim kryesor** që të sigurojë funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të integritetit në nivel bashkie si dhe do të ndihmojë administratën vendore në përpjekjet e saj për forcimin e etikës dhe integritetit.

Si dokument, plani ka **objektiva të qartë** si :

- Pasurimin e kuadrit strategjik të intitucionit të bashkisë
- Promovimin e vlerave të mirëqeverisjes
- rritjen e besimit të qytetarëve tek institucioni
- sigurimin e shërbimeve cilësore për komunitetin
- garantimi i një niveli sa më optimal të transparencës, llogaridhënies, si dhe përfshirjes e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e bashkisë.
- Bashkëpunimin sa më efektiv dhe të shpejtë ndërmjet zyrave, sektorëve dhe drejtorive.

2. Për të gjitha qëllimet e lartpërmendura propozohet të miratohet plani i integritetit për Bashkinë Pukë . si dokument i sigurimit të cilesinë së integritetit.

Drejtore i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
Emirjona Pergjegjaj